NPB
NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.
PUBLIC HOUSING ENTERPRISE J.S.C.
Pranuar: 23. 04. 2019
Njës.Org. Numri: Shtojca: Vlera:
02-02-512/1

Ndërmarrja Publike Banesore-SH.A.

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE - MINISTARSTVO FINANCIJE - MINISTRY OF FINANCE
KËSHILLI I KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR
KOSOVSKI SAVET ZA FINANSIJSKO IZVESTAVANJE
KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL
Nr./Br./No. 22/2019 Nr.faq./Br.str./No.pg.
Data/Datum/Dato 23.04.2019
PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISHTINA

Përmbajtja

Raporti i auditorit të pavarur	**3**
Pasqyrat financiare	
Pasqyra e Pozitës Financiare	**5**
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	**6**
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	**7**
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	**8**
Shenimet e pasqyrave financiare	**11**

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhmentin dhe Aksionarët e Ndërmarja Publike Banesore-SH.A.

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare Ndërmarja Publike Banesore-SH.A., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e theksimit e çështjes të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë) për pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2018, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tone.

Theksimi i çështjes

Siç është shpalosur në notën 6 te pasqyrave financiare përcjellëse, me 31 Dhjetor 2018, bilanci i të arkëtueshmeve tregtare neto të Ndërmarrjes është 2,734,165 Euro (31 Dhjetor 2017; 2,397,343 Euro).
Për shkak të natyrës së shënimeve të Kompanisë lidhur me provezionimet e borxheve të kqija nga vitet paraprake, ne nuk ishim në gjendje që me aplikimin e procedurave standarde dhe alternative ta bindemi veten tonë ne lidhje me saktësin e të arkëtueshmeve tregtare neto për vitin 2018.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit. Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuara personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arësye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfititmet në favor të interesit publik.

"Univerzum Audit" Sh.p.k.
Qerim Qerimi-Auditor Ligjor
Besa Berisha-Auditore Ligjore
Aresa: Q.T.Bregu i Diellit,lok.26

Prishtine, 06.04.2019

Ndërmarrja Publike Banesore-SH. A

Pasqyra e Pozitës Financiare

	Shënim	Me 31 Dhjetor 2018	Me 31 Dhjetor 2017
Pasuritë			
Pasuritë qarkulluese			
Paraja dhe Ekuivalentet e Parasë	5	574,287	191,829
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	6	2,734,165	2,397,343
Parapagimet	7	758,388	839,347
Investimet në depozita	8	900,000	1,200,000
Stoqet	9	339,666	255,971
Investimet në aksione në kompani tjera		27,600	27,600
Investimet në vijim - te mbajtura për shitje		644,333	1,583,850
Total pasurite qarkulluese		**5,978,439**	**6,495,940**
Pasuritë jo qarkulluese			
Toka	10	28,016,575	27,090,000
Prona, Impiantet dhe Pajisjet		45,901,152	44,906,433
Investimet në hapësira të përbashkëta		296,875	65,409
Total pasurite jo qarkulluese		**74,214,603**	**72,061,842**
Totali Pasuritë		**80,193,042**	**78,557,782**
Ekuiteti dhe Detyrimet			
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet	11	737,485	636,213
Të hyrat e shtyra	12	597,398	596,225
Total detyrimet		**1,334,883**	**1,232,438**
Ekuiteti			
Kapitali Aksionar dhe Rezervat	13	12,595,160	12,595,160
Fitimet / (Humbjet) e Akumuluara		(1,255,807)	(2,217,763)
Rezerva e Rivlerësimit		67,976,350	66,866,127
Fitimi / (humbja) e vitit		(457,543)	81,820
Total ekuiteti		**78,858,159**	**77,325,344**
Total detyrimet dhe ekuitetit		**80,193,043**	**78,557,782**

Pasqyra e PozitësFinanciare duhet lexuar së bashku me shënimet pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.
Pasqyrat financiare janë aprovuar dhe nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv më 23/04/2019.

Kryeshef Ekzekutiv

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A. NPB PRISHTINË

Zyrtar Kryesor Financiar
dhe i Thesarit

Ndërmarrja Publike Banesore-SH. A

Pasqyra e të Hyrave Gjithpërfshirëse

	Shënim	Me 31 Dhjetor 2018	Me 31 Dhjetor 2017
Të hyrat operative	14	1,740,901	2,457,788
KMSH		20,424	449,655
Fitimi Bruto		**1,720,477**	**2,008,133**
Shpenzimet e zhvlerësimit	10	1,069,586	675,021
Shpenzimet e personelit	15	894,588	821,398
Shpenzimet operative	16	241,232	447,605
Total shpenzimet operative		**2,205,405**	**1,944,024**
Fitimi/Humbja nga operimet		**(484,928)**	**64,109**
Të hyrat tjera jo operative		27,385	22,343
Të hyrat nga rritja e vlerës në aksione			
Fitimi / (Humbja) para tatimit		**(457,543)**	**86,452**
Kontributi Bëmirës		-	4,630
Fitimi para tatimit		**(457,543)**	**81,822**
Tatimi në fitim	17	-	-
Fitimi /Humbja e vitit		**(457,543)**	**81,822**
Të hyrat gjithpërfshirëse tjera		1,945,427	66,866,127
Total të hyra gjithpërfshirëse		**1,487,884**	**66,947,949**

Pasqyra e te hyrave gjithperfshirese duhet lexuar së bashku me shënimet pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar dhe nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv më 23/04/2019.

Kryeshef Ekzekutiv

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A. NPB PRISHTINË

Zyrtar Kryesor Financiar
dhe i Thesarit

Ndërmarrja Publike Banesore-SH. A

Pasqyra e Ndërrimeve në Ekuitet

	Kapitali aksionar dhe rezervat	Rezervat e Rivlerësimit	Humbjet e mbajtura	TOTALI
Gjendja me 1 Janar, 2017	**12,595,160**	-	**(3,252,449)**	**9,342,711**
Rezerva e rivleresimit		**67,343,493**	-	**67,343,493**
Fitimi i vitit	-	-	**81,821**	**81,821**
Korigjimet për gabimet paraprake shen.13	-		427,980	**427,980**
Të hyrat nga provizionimi I borxheve të dyshimta			129,340	**129,340**
Zhvleresimi I tepricës së rivlerësimit	-	(477,365)	477,365	-
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse	-	-		-
Gjendja me 31 Dhjetor, 2017	**12,595,160**	**66,866,128**	**(2,135,943)**	**77,325,345**
Gjendja me 1 Janar, 2018	**12,595,160**	**66,866,128**	**(2,135,943)**	**77,325,345**
Rezerva e rivleresimit		(835,206)	835,206	-
Fitimi i vitit			(457,543)	**(457,543)**
Korigjimet për gabimet paraprake shen.13			(8,293)	**(8,293)**
Të hyrat nga provizionimi I borxheve të dyshimta			53,223	**53,223**
Zhvleresimi I tepricës së rivlerësimit			-	-
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse		1,983,470		**1,983,470**
Shpenim gjitheperfshirese		(38,043)		**(38,043)**
Gjendja me 31 Dhjetor, 2018	**12,595,160**	**67,976,350**	**(1,713,350)**	**78,858,159**

asqyra e Ndrrimeve në Ekuitet duhet lexuar së bashku me shënimet, pjese përbërëse e pasqyrave financiare

Kryeshef Ekzekutiv

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A. NPB PRISHTINË

Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit

Ndërmarrja Publike Banesore-SH. A
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

	Shënim	Me 31 Dhjetor 2018	Me 31 Dhjetor 2017
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Neto profiti para tatimit		(457,543)	81,821
Korrigjimet:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		1,069,586	675,020
Të hyrat nga investimet në aksione		0	0
Të hyrat nga provizionimi I borxheve të dyshimta		53,223	129,340
Korigjimet nga vitet paraprake		(8,293)	427,980
Fitimi para ndryshimit ne asetet dhe obligimet operative		**656,973**	**1,314,162**
Rritja e stoqeve		(83,695)	(193,020)
Zvogëlimi/ (Rritja) në llogaritë e arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(255,863)	(572,671)
Zvogëlimi/ (Rritja) në investimet në vijim për shitje		939,517	139,139
Zvogëlimi/ (Rritja) në llogaritë e pagueshme dhe të tjera		101,272	320,943
Zvogëlimi/ (Rritja) në të hyra e shtyra		1,173	(865,912)
Paraja e gjeneruar nga/ (e përdorur në) aktivitetet operative		**1,359,378**	**142,641**
Tatimi në fitim		**0**	**0**
Neto paraja e gjeneruar (përdorur) në operacionet		**1,359,378**	**142,641**
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve		(1,276,921)	(152,231)
Shitja e pronës, impianteve dhe paisjeve		0	0
Paraja e përdorur në aktivitetet investive		**(1,276,921)**	**(152,231)**
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese:			
Ritja në depozita		300,000	(300,000)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		**300,000**	**(300,000)**
Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të parasë		**382,458**	**(309,590)**
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		**191,828**	**501,418**
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		**574,286**	**191,828**

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë duhet lexuar së bashku me shënimet, pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Kryeshef Ekzekutiv

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SHA NPB PRISHTINË

Zyrtar Kryesor Financiar
dhe i Thesarit

---

1. TË PËRGJITHSHME

Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinëështë e regjistruar sipas rregullores së UNMIK-ut 2001/6 NRB: 70170765 ne MTI - Zyra e Regjistrimit te Ndërnarrjeve Biznesore dhe Emrave Tregtar në Kosovë.

Ndërmarrja është regjistruar dhe riegjistruar(vitin 2000 dhe 2004),si Ndërrnarrje Publike Banesore, me seli në Prishtinë. Deri në miratimin e Ligjit Nr.03/L-OB7 për Ndërmarrjet Publike, ndërmarrja është administruar nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, kurse prej Qershorit të vitit 2008,administrohet nga Komuna e Prishtinës, pronare e së cilës është 100%. Pas miratimit të rregulloreve, përkatësisht të Statutit dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative, nga Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtine(dt.05.07.2011) ndërmarrja, në Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë-Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Republikën e Kosovës, është regjistruar si Ndërmarrje Publike Banesore-SHAnë Prishtinë.

Veprimtari e ndërmarrjes është ndërtimi i objekteve banesore-afariste, industriale, administrative, arsimore, shëndetësore, mbikëqyrja, projektimi, revidimi i projekteve, kontrollimi teknik i objekteve. Gjithashtu, veprimtari e ndërmarrjes është administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave individuale si dhe ne bashkëpronësi, duke përfshi mirëmbajtjen e higjienës në hapësira të përbashketa (instalimeve elektrike, ndriçmin, ngjyrosjen e mureve, servisimin e rregullt të ashensorëve, të aparateve kundër zjarrit, ujësjellësit, kanalizimit, deratizimin, pastrimin e ulluqeve, mirëmbajtjen e oxhaqeve etj. si dhe menaxhimin dhe administrimin e pasurisë komerciale të Ndërmarrjes.

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklaratë e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ("BSNK").

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç rastit të rivlerësimit të disa aseteve siç është shpjeguar më poshtë në politikat e kontabilitetit. Kostoja historike është përgjithësisht e bazuar në vlerën e drejtë të shumës së dhënë në këmbim të mallrave dhe shërbimeve.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në valutën EURO, e cila është monedha funksionale e Kompanisë.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe i shërbimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, si dhe të ardhurave dhe të shpenzimeve.

(e) Supozimi e vijimësisë

Pasqyra e Pozicionit Financiar dhe Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse janë përgatitur sipas supozimit të vijimësisë, e cila supozon se Kompania do të jetë në gjendje të realizon pasuritë e saj dhe të përmbushë obligimet në operacionet normale të biznesit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

(a) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.
Kostoja përshinë shpenzime që i atribuohen direkt blerjes së aktivit afatgjatë material. Kostoja e aktiveve afatgjata materiale të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe të punës direkte si dhe çfarëdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit afatgjatë material në gjendjen funksionale për funksionimin e tij. Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponente kryesore) të aktiveve afatgjata.
Një element i pronës dhe pajisjeve çregjistrohet nga pasqyrat financiare në momentin e shitjes ose kur nuk pritet ndonjë përfitim ekonomik nga përdorimi i vazhdueshëm i asaj pasurie. Çfardo fitimi ose humbje nga shitja e një elementi të pronës dhe pajisjeve përcaktohet si diferenca në mes të të hyrave nga shitja dhe vlerës bartëse të pasurisë dhe njihet në fitim ose humbje.

Më 01.01.2018 në librat kontabël është regjistru vlera e rivlerësuar e aseteve duke rritur vlerën e asteve dhe rritur rezervën rivlerësuese në vlerë prej **1,983,470 EURO**.Gjatë procesit të rivlerësimit janë evidentuar të gjitha asetet pronë e NPB-së dhe njëkohësisht është bërë hamronizimi i të dhënave kontabël mbi astetet me te dhënat fizike të tyre, duke mundësuar kështu tani e tutje identifikim e secilit aset dhe vendodhjen e tij.Disa nga asetet e rivlerësuara janë kryesisht asete të cilat nuk kanë qenë të evidentuara në librat kontabël të kompanisë. Vlerësimi i aseteve është kryer nga ekspertë të jashtëm për astetet e rivlerësuara.

SNK 16. Matja pas njohjes: Nëse vlera e drejtë mund të matet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike mund të mbajë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të së njëjtës klasë me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësim.

Shuma e rregullimit që vje nga riparaqitja ose eleminimi I amortizimit të akumuluar formon pjesë të rritjes ose pakësimit të vlerës kontabël (neto).
Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja kreditohet drejtpërdrejt tek kapitalet e veta me titullin mbivlerë (tepricë) rivlerësimi. Megjithatë, rritja njihet në fitim ose humbje për aq sa kjo mbulon uljen e rivlerësimit e të njëjtit aktiv të njohur më parë në fitim ose humbje.

Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi ulet si rezultat i një rivlerësimi, ulja njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja debitohet drejtpërdrejtë tek kapitalet e veta me titullin mbivlera (tepricë) rivlerësimi për aq sa ajo mbulon çdo tepricë kreditore tek mbivlera (teprica) rivlerësimi në lidhje me atë aktiv.

Modeli i rivlerësimit

Pas njohjes si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të mbartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësim. Rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e bilancit.

Mosnjohja

Vlera kontabël (neto) e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) nuk do të njihet:

(a) në nxjerrjen nga përdorimi; ose

(b) kur nuk priten më përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi i tij ose shitja.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet me vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhme që i atribuohen atij elementi do t'i përkasin Kompanisë, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë jetës së dobishme të aktiveve. Zhvlerësimi kalkulohet duke përdorur metodën lineare. Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) rivlerësohen në datën e raportimit.
Prona dhe pajisjet zhvleresohen sipas metod ë s lineare me normat si në vijim:

- Ndërtesat dhe strukturat e ngjashme ndërtimore 30-60vite
- Automjete 10-20vite
- Pajisje dhe mobile 20 vite
- Pasuri tjera joqarkulluese 5vite

Klasifikimi dhe trajtimi i aseteve të Kompanisë

SNK 36 Një *treg aktiv* është një treg në të cilin ekzistojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) artikujt që tregtohen brenda tregut janë homogjenë;

(b) mund të gjenden normalisht në çdo kohë blerës dhe shitës të vullnetshëm; dhe

(c) çmimet janë të disponueshme nga publiku.

SNK 40 Aktiv afatgjatë material i investuar është pasuria (toka ose ndërtesa —ose pjesë e ndërtesës —ose të dyja) e mbajtur (nga pronari ose nga qiramarrësi sipas një qiraje financiare) për të siguruar të ardhura nga qiraja ose për rritjen e vlerës së kapitalit apo të dyja, me përjashtim kur:

(a) përdoret për prodhimin ose furnizimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve ose për qëllime administrative; ose

(b) shitet në rrjedhën normale të biznesit

Aktivi afatgjatë material i investuar do të njihet si një aktiv kur, dhe vetëm kur:

(a) ka probabilitet që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me aktivin afatgjatë material të investuar do të merren nga njësia ekonomike; dhe

(b) kostoja e aktivit afatgjatë material të investuar mund të matet me besueshmëri

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

(b) Stoqet

Stoqet maten me shumën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.Kosto përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e vlerësuara për përfundimin dhe realizimin e shitjes.

(c) Instrumentet financiare

Kompania mban vetëm instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, hua dhe llogari të pagueshme.Instrumentet financiare jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e drejtë, për instrumentet që nuk janë të shprehura në vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre.Pas njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivative vlerësohen si më poshtë.

Një instrument financiar njihet në rast se Kompania bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.Aktivet financiare nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Kompanisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse Kompania i transferon aktivin financiar një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivit.Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, pra datën në të cilën Kompania zotohet të blejë ose te shesë aktivin.Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Kompanisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në banka, të tjera investime afatshkurtra likuide me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një risku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Kompania në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët e saj vlerësohen me koston e amortizuar.

Llogari të arkëtueshme tregtare

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuara me humbjet nga rënia në vlerë.

Llogari të pagueshme tregtare dhe tjera

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

Huazimet (Transferi i fondeve tepricë tek palët e lidhura)

Huazimet nga aksionarët njihen në fillim sipas kostos historike. Huazimet tjera njihen në fillim sipas vlerës së drejtë. Huazimet më pastaj barten sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Kompania paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur arrijnë moshën për pension.Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.Kontributet e Kompanisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Kompania njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhen në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

(f) Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

(g) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë.Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrëështë llogaritur duke përdorur metodën e detyrimit në bilanc, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimi financiar dhe bazës tatimore.Shuma e tatimit të shtyrëështë llogaritur bazuar në metodën e realizimit ose kompensimit të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur shkallë tatimore që janë në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e raportimit.
Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq saështë e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit aktivi të mund të përdoret. Aktivi tatimor i shtyrë zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

(h) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare, llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël neto, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

SNK 37-Provizionimi i Detyrimeve Kontigjente

Një *pasiv pasiv i kushtëzuar* është:

(a) një detyrim i mundshëm që rrjedh nga ngjarje të shkuara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nga zhvillimi ose jo i një ose disa ngjarjeve të ardhshme të pasigurta jo tërësisht nën kontrollin e njësisë ekonomike; ose

(b) një detyrim aktual që rrjedh nga ngjarje të shkuara por që nuk është njohur sepse:

(i) nuk ka mundësi që për të shlyer detyrimet të kerkohet një dalje burimesh që përfshin përfitime ekonomike; ose

(ii) shuma e detyrimit nuk mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme

Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion që ka mundësi reale ngjarjet konstruktive apo ligjore në të ardhmen do të kërkojnë dalje burimesh, një detyrim i pësuar në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

Asetet Kontigjente

Një *aktiv i kushtëzuar* është një detyrim i mundshëm që rrjedh nga ngjarje të shkuara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nga zhvillimi ose jo i një ose disa ngjarjeve të ardhshme të pasigurta, jo tërësisht nën kontrollin e njësisë ekonomike.

4. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TE RISHIKUARA

2.1 Standardet dhe Interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Më poshtë janë paraqitur ndryshimet në standardet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e lëshuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve për Raportimin Financiar të cilat janë në fuqi për periudhën aktuale:

Standardi	Pershkrimi	Data efektive
SNRF 5	Aktivet Afatgjata që Mbahen për Shitje dheOeracionet e nderprera-Ndryshimet e metodave ne dispozicion	që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016
SNRF 7	Instrumentet Financiare: Shpalosja e kontratave per sherbimeZbatueshmeria dhe kompenzim Dhenia e informacionece te shpjeguese ne pasqyrat financiare	që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016
SNRF 14	Rregullatori i llogarive te shtyera	
Ndryshimet ne SNRF 10	Konsolidimi i pasqyrave financiare	që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016
Ndryshimet ne SNRF 11	Marreveshjet	që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016
